



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 qershor 2024
Nr. ref.:RK 2445/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI105/23

Parashtrues

Naim Avdiu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
ARJ.nr.125/2022, të 27 dhjetorit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Naim Avdiu nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [ARJ.nr.125/2022] e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të 27 dhjetorit 2022, në lidhje me Aktgjykimin [AA.nr.600/20] e Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), të 19 majit 2022 dhe Aktgjykimin [AA.nr.1130/2016] e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), të 9 janarit 2018.
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 31 janar 2023.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) si dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 20 [Vendimet] dhe 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë para shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 25 maj 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 31 maj 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR.KI 105/23], caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr.KSH.KI105/23], Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
9. Më 6 qershor 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës si dhe një kopje të kërkesës i dërgoi Gjykatës Supreme.

10. Më 20 korrik 2023, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe ia kërkoi kësaj të fundit që të dorëzojë në Gjykatë fletë-kthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
11. Më 14 shkurt 2024, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore, që të dorëzon në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.
12. Më 20 shkurt 2024, Gjykata Themelore, dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.
13. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë
14. Më 30 prill 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Përmbledhja e fakteve lidhur me procesin penal kundër parashtruesit të kërkesës

15. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 31 maj 2013, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës kishte ngritur Aktakuzën [PRS.37.71] kundër parashtruesit të kërkesës dhe dy të tjerëve nën dyshimin e bazuar se kishte kryer veprën penale “*shmangje e detyrimeve me mashtrim*” sipas paragrafi 92 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/1 të 30 janarit 2014 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës.
16. Më 27 maj 2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë përmes Aktgjykimit [P.nr.904/13], shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe dy të tjerë për veprën penale për të cilën akuzohej, duke e dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh të cilat nuk do të ekzekutohen nëse në afat prej 3 (tre) vitesh nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.
17. Në një datë të paspecifikuar parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër vendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale.
18. Më 9 shkurt 2015, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1.nr.1166/14] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, dhe vërtetoi vendimin e shkallës së parë.
19. Në një datë të paspecifikuar parashtruesi i kërkesës dhe dy të tjerë parashtruan kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit [P.nr.904/13], të 27 majit 2014, dhe Aktgjykimit [PA1.nr.1166/14], të 9 shkurtit 2015, të Gjykatës së Apelit, ku parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të ligjit penal dhe shkelje të dispozitave të procedurës penale.
20. Më 20 shtator 2016, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr.128/2016] miratoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës dhe anuloi dy vendimet e lartpërmendura me të cilat parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor. Gjykata Supreme në arsyetim të Aktgjykimit të saj konstatoi se gjykata e shkallës së parë nuk kishte përshkruar “*mënyrën mashtruese e shmangjes nga pagesa e detyrimit, edhe pse kjo mënyrë është elementi qenësor i veprës penale për të cilën të dënuarit janë shpallur fajtor*”

21. Më 2 mars 2022, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [P.nr.127/16], pushoi procedurën penale ndaj parashtruesit të kërkesës për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Përmbledhja e fakteve që ndërlidhet me largimin nga puna të parashtruesit të kërkesës

22. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 25 shkurt 2016, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Bordi i Drejtorëve të AKP-së) përmes Vendimit [Nr.Ref.BD-72/3], shkarkoi nga detyra parashtruesin e kërkesës, nga pozita e Zëvendës Drejtorit Menaxhues, Divizioni i Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
23. Më 16 mars 2016, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) duke pretenduar shkelje të dispozitave procedurale dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
24. Më 23 mars 2016, Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave pranë AKP-së, përmes Vendimit [Nr.KZKA-4-2016], u shpall jokompetent në këtë çështje administrative.
25. Më 22 prill 2016, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme KPMSHCK) kundër Vendimit [Nr.Ref.BD-72/3], të 25 shkurtit 2016, të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.
26. Më 20 qershor 2016, KPMSHCK përmes Vendimit [A02/154/2016], refuzoi si të pabazuar ankesën duke lënë në fuqi Vendimin [Nr.Ref.BD-72/3], të 25 shkurtit 2016, të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Përmbledhja e fakteve që ndërlidhet me procedurën gjyqësore

27. Më 26 korrik 2016, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore kundër vendimeve të lartpërmendura, duke pretenduar specifikisht se Vendimi i KPMSHCK-së në rastin konkret “*nuk ka marrë parasysh një lëmi të tërë juridike siç është procedura nga marrëdhënia e punës dhe Ligjin e Punës, duke injoruar atë dhe menjëherë ka hyrë në shqyrtim material të lëndës pa e kaluar shqyrtimin formal të saj.*”
28. Më 9 janar 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.1130/2016], refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit, duke e konsideruar si të drejtë dhe të ligjshëm Vendimin e KPMSHCK-së.
29. Në një datë të paspecifikuar parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar se (i) gjendja faktike nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë; (ii) shkelje të dispozitave tjera procedurale; (iii) duke kërkuar kthim në vendin e punës, dhe (iv) kompensimin e pagave.
30. Më 2 gusht 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA.nr.291/2018], aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit, duke konsideruar se Aktgjykimi [A.nr.1130/2016], i 9 janarit 2018, i Gjykatës Themelore është i përfshirë me të meta thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, respektivisht nga paragrafi 2 i nenit 182 i Ligjit të Procedurës Kontestimore. Gjykata e Apelit më tej në arsyetim të Aktvendimit

të saj theksoi se gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte vërtetuar gjendjen e faktike.

31. Më 15 nëntor 2019, Gjukata Themelore duke vepruar në rigjykim përmes Aktgjykimit [A.nr.2060/201], refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit. Në arsyetim të Aktgjykimit të saj, Gjukata Themelore theksoi se vendimi për shkarkimin nga pozita e Zëvendës Drejtorit Menaxhues, Divizioni i Likuidimit të AKP-së, është bërë konform nenit 16 të Ligjit për AKP-në, sepse duke marrë parasysh përmbajtjen e kësaj të fundit pikërisht Bordi i Drejtorëve të AKP-së është kompetent për emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në AKP. Si rrjedhojë Gjukata Themelore, konsideron se në rastin konkret KPMSHCK-ja, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.
32. Në një datë të paspecifikuar parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjukatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjukatës Themelore, duke pretenduar se gjendja faktike nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe shkelje të dispozitave tjera procedurale, duke kërkuar kthim në vendin e punës dhe kompensimin e pagave. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Gjukata Themelore në rastin konkret nuk ka marrë parasysh Aktgjykimin e Gjukatës Supreme, përmes së cilit ish-in anuluar vendimet e shkallëve më të ulëta me të cilat parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor për veprën penale për të cilën akuzohej.
33. Më 19 maj 2022, Gjukata e Apelit përmes Aktgjykimit [A.A.nr.600/20], refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës duke konsideruar se shkalla e parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike si dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat materiale.
34. Gjukata e Apelit në arsyetim të Aktgjykimit të saj thekson se AKP-ja me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës për parashtruesin e kërkesës, kishte vepruar drejtë duke u thirrur në paragrafin 1 të nenit 58 të Ligjit për të drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, duke shtuar se *“Në këtë rast veprimet e paditësit të konstatuara nga Bordi i Drejtorëve kualifikohen si veprime që përbëjnë shkelje të rëndë të detyrave të punës, për çka Gjukata e Apelit vlerëson se masa e shqiptuar nga punëdhënësi është proporcionale me natyrën e shkeljes e rrjedhimisht është masë e ligjshme”*.
35. Lidhur me pretendimin e parashtruesit se nuk ishte marrë parasysh Aktgjykimi i Gjukatës Supreme, përmes së cilit ish-in anuluar vendimet e shkallëve më të ulëta me të cilat parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor për veprën penale për të cilën akuzohej, Gjukata e Apelit thekson se *“në rastin konkret nga aktgjykimi penal paditësi është dënuar, mirëpo aktgjykimi është prishur dhe lënda është kthyer në rigjykim në gjukatën e shkallës së parë, dhe në ndërkohë ka arritur parashkrimi absolut i veprës penale dhe mbi këtë bazë nuk është arritur të vërtetohet ose jo përgjegjësia penale e paditësit për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.”*.
36. Më 7 qershor 2022, Gjukata e Apelit përmes Aktvendimit [A.A.nr.600/22], korrigjoi Aktgjykimin [A.A.nr.600/20] e Gjukatës së Apelit, të 19 majit 2022, respektivisht rreshtin e tretë të dispozitivit ku i është referuar në mënyrë të gabuar Aktgjykimit [A.nr.2060/201], të 15 nëntorit 2019, të Gjukatës Themelore.
37. Në një datë të paspecifikuar parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të

Gjykatës Apelit, të 19 majit 2022, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave procedurave dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

38. Më 27 dhjetor 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ.nr.125/2022], refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, duke konsideruar se edhe Gjykata e Apelit dhe Gjykata Themelore drejt kanë aplikuar të drejtën materiale kur kanë refuzuar kërkesës padinë e parashtruesit kundër Vendimit të KPMSHCK-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

39. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të të drejtat e tij të mbrojtura nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

(i) *Pretendimet përkitazi me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës*

40. Parashtruesi i kërkesës thekson se të gjitha vendimet administrative si dhe të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta “nuk i kishin trajtuar pretendimet e parashtruesit se i njëjti ishte larguar nga puna pa arsytim”.

41. Parashtruesi i kërkesës thekson se çështjen e mungesës së arsytimit në vendimin me të cilin ishte larguar nga puna e kishte ngritur në të gjitha instancat e gjykatave të rregullta dhe nuk kishte marrë përgjigje sa i përket kësaj çështje.

42. Më tej parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendon se instancat e rregullta nuk ishin përgjigjur në pretendimin e tij se paragrafi 2 i nenit 100 të Kodit Penal të Kosovës, i cili ishte në fuqi në kohën kur parashtruesi ishte larguar nga puna, “nuk ka mundur të përdoret si bazë për largim nga puna për faktin se kjo dispozitë përcaktonte shprehimisht se dënimi me kusht nuk krijon pasoja juridike dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës nuk është dashur të realizohej mbi këtë bazë”.

43. Parashtruesi i kërkesës shton se gjykatat e rregullta në rastin konkret nuk e kishin marrë parasysh Aktgjykimin [PML.nr.128/2016], të Gjykatës Supreme, i cili i kishte anuluar Aktgjykimet e instancave më të ulëta me të cilat parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor.

(ii) *Pretendimet përkitazi me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës*

44. Në ndërlidhje me këtë parashtruesi pretendon se gjykata e rregullta duke mos arsyetuar vendimet “kanë rënë ndesh edhe me buletinin e praktikës gjyqësore” të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës e cila ka një sërë rastesh kur ka konstatuar se vendimet duheshin arsyetuar”.

(iii) *Pretendimet përkitazi me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës*

45. Në ndërlidhje me këtë parashtruesi pretendon se gjykata e rregullta në këtë rast “prejudikojnë fajësinë e parashtruesit” edhe pse Gjykata Supreme i kishte prishur vendimet me të cilat parashtruesi ishte shpallur fajtor.
46. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe të anuloj të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta dhe vendimet administrative me të cilat parashtruesi ishte larguar nga puna.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për veprë penale ka të drejtë t’u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për veprë penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin”.

Neni 49

[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]”

LIGJI Nr. 04/L-034
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 16

Menaxhmenti dhe personeli

1. Drejtori Menaxhues me ndihmën e dy Zëvendës drejtorëve menaxhues është përgjegjës për:

1.1.kryerjen e të gjitha funksioneve që i janë deleguar atij nga Bordi;

1.2.zhvillimin e veprimtarisë së rregullt të Agjencisë në pajtim me politikën dhe udhëzimet që mund të nxirren nga Bordi;

1.3.organizimin, emërimin dhe largimin nga puna të personelit (përveç Zëvendës drejtorëve menaxhues dhe zyrtarëve të tjerë, emërimin e të cilëve Bordi e ka rezervuar për vete) në pajtim me vendimet e marra ose udhëzimet e nxjerra nga Bordi;

*1.4.përgatitjen e mbledhjeve të Bordit dhe sigurimin e zbatimit të vendimeve të Bordit;
dhe*

1.5.kryerjen e çfarëdo funksioni në marrëveshje me Bordin në pajtim me nenin 2 paragrafi 2.2. të këtij ligji.

2. Drejtori menaxhues i raporton Bordit dhe i përgjigjet vetëm atij dhe asnjë pale tjetër.

3. Drejtori menaxhues dhe dy Zëvendës drejtorët menaxhues emërohen nga Bordi. Kryesuesi është përgjegjës për nominimin e kandidatëve për këto pozita në pajtim me procedurat që do të përshihen në rregullore të miratuar nga Bordi dhe lëshuar nga Agjencia. Drejtori menaxhues dhe zëvendës drejtorët menaxhues në çdo kohë mund të shkarkohen nga Bordi. Bordi vendosë për kompensimin dhe kushtet e tjera të shërbimit të drejtorit dhe Zëvendës drejtorëve menaxhues, pacenuar nenin 16 paragrafi 5 më poshtë. Drejtori Menaxhues apo njëri nga zëvendës drejtorët menaxhues të caktuar nga Drejtori Menaxhues janë të pranishëm në secilin takim të Bordit me qëllim të dhënies së këshillave dhe informatave për Bordin dhe të përgjigjes në pyetjet e parashtruara atyre nga anëtarët e Bordit. Kur Bordi diskuton çfarëdo çështje të interesit specifik personal për Drejtorin Menaxhues apo zëvendës drejtorin menaxhues i cili është i pranishëm, Kryesuesi mund të kërkojë që ai person të mos jetë i pranishëm gjatë

bisedimeve. Drejtori Menaxhues dhe dy zëvendës drejtorët menaxhues nuk kanë të drejtë vote në takimet e Bordit.

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

47. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

48. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

49. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

50. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është: (i) palë e autorizuar; (ii) konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ.nr.125/2022] e 27 dhjetorit 2022, të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [AA.nr.600/20] e 19 majit 2022, të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [AA.nr.1130/2016] e 9 janarit 2018, të Gjykatës Themelore; (iii) ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; (iv) ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj; si dhe (v) e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.

51. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, pika d) e paragrafit 1 dhe paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcaktojnë që:

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj".

52. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "qartazi e pabazuar" në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "pretendime qartazi të pabazuara". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime "të shkallës së katërt"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes"; (iii) pretendime "të pambështetura apo të paarsyetuara"; dhe në fund, (iv) pretendime "konfuze dhe të paqarta". Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si "qartazi të pabazuar", dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si "qartazi të pabazuara" të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore, përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet [KI40/20](#), parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021; [KI163/18](#), parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; [KI21/21](#), parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021, [KI107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021).
53. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit si dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
54. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me largimin nga puna të parashtruesit të kërkesës, nga pozita Zëvendës Drejtorit Menaxhues, Divizioni i Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Prokuroria Speciale kishte ngritur aktakuzë ndaj parashtruesit të kërkesës me dyshimin e bazuar se kishte kryer veprën penale "shmangie e detyrimeve me mashtrim" për çka edhe ishte dënuar nga Gjykata Themelore me dy vite burgim, të cilin dënim nuk do ta mbante nëse brenda periudhës 3 vjeçare nuk kryen veprë tjetër penale. Gjykata e Apelit kishte miratuar vendimin e Gjykatës Themelore. Më pas Gjykata Supreme duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, miratoi të njëjtën duke anuluar vendimet e instancave më të ulëta. Gjykata Themelore më pasr pushoi procedurën penale ndaj

parashtruesit pasi që kishte arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Më pas Bordi i Drejtorëve të AKP-së kishte larguar nga puna parashtruesin e kërkesës. Vendimi i Bordit të Drejtorëve ishte miratuar nga KPMSHCK dhe më pas ky vendimi i KPMSHCK-së ishte vërtetuar nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.

55. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të të drejtat e tij të mbrojtura me nenet 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe nenet 49 dhe 54 të Kushtetutës, në thelb, për shkak të: (i) mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor.
56. Andaj, në vijim, Gjykata do të trajtojë veç e veç pretendimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës.

I. Pretendimet përkitazi me mosarsyetimin të vendimit gjyqësor

(i) Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar

57. Garancitë e mishëruara në nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre. (shih rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, nr. 8950/80, Aktgjykim, i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, Aktgjykim, i 15 dhjetorit 2022, paragrafi 113). Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë.
58. Përkundër faktit që gjykata e brendshme ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjen për pranueshmërinë e dëshmimeve, ajo është e detyruar të justifikojë veprimet e saj duke arsyetuar të gjitha vendimet e saj (shih rastet e GJEDNJ-së: *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801/97, Aktgjykim, i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe rastin *Carmel Saliba kundër Maltës*, nr. 24221/13, Aktgjykim, i 24 prillit 2017, paragrafi 73 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, Aktgjykim, i 15 dhjetorit 2022, paragrafi 114).
59. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër, duhet të jap arsye dhe arsyetime të tilla të cilat do t'u mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih rastin e GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, Aktgjykim, i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, paragrafi 115).
60. Neni 6, paragrafi 1, i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih rastet e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, Aktgjykim, i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim, i 29 janarit 1999, paragrafi 26; *Perez kundër Francës*, nr. 47287/99, Aktgjykim, i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 116).
61. Nga natyra e vendimit që merr gjykata, varet nëse gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtrësive që një palë mund t'i paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjyqimeve (shih rastet e GJEDNJ *Ruiz Torija kundër*

- Spanjës*, [nr. 18390/91](#), Aktgjykim, i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, [nr. 18064/91](#), Aktgjykim, i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 117).
62. Megjithatë, nëse parashtresa e një pale është vendimtare për rezultatin e procedurës, ajo kërkon që t'i përgjigjet në mënyrë specifike dhe pa vonesë (shih rastet e GJEDNJ-së, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, të cituar më lart, paragrafi 30; *Hiro Balani kundër Spanjës*, të cituar më lart, paragrafi 28 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 118).
63. Prandaj, gjykatat janë të obliguara që:
- (a) të shqyrtojnë argumentet kryesore të palëve (shih rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, [nr. 61302/00](#), Aktgjykim, i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; *Donadze kundër Gjeorgjisë*, [nr. 74644/01](#), Aktgjykim, i 7 qershorit 2006, paragrafi 35); dhe
- (b) të shqyrtojnë me shumë rigorozitet dhe kujdes të veçantë kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe Protokollat e saj (shih rastet e GJEDNJ-së: *Fabris kundër Francës*, [16574/08](#), Aktgjykim, i 7 shkurtit 2013, paragrafi 72; *Wagner dhe JMWL kundër Luksemburgut*, [nr. 76240/01](#), Aktgjykim, i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).
64. Neni 6, paragrafi 1, nuk kërkon që Gjykata Supreme të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih rastet e GJEDNJ-së, *Burg dhe të tjerët kundër Francës*, nr. [34763/02](#); Vendim, i 28 janarit 2003; *Gorou kundër Greqisë* (nr. 2), [nr. 12686/03](#), Vendim, i 20 marsit 2009, paragrafi 41 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 120).
65. Në mënyrë të ngjashme, në një rast ku bëhet fjalë për një kërkesë që të lejohet parashtrimi i ankesës, që është një parakusht për procedurën e një gjykatë më të lartë, si dhe për një vendim të mundshëm, neni 6, paragrafi 1, nuk mund të interpretohet në atë kuptim që të urdhëron një arsyetim të detajuar të vendimit për refuzimin e kërkesës për parashtrimin e ankesës (shih rastet e GJEDNJ-së, *Kukkonen kundër Finlandës* (nr. 2), nr. [47628/06](#), Aktgjykim, i 13 prillit 2009,) paragrafi 24; *Bufferne kundër Francës*, nr. [54367/00](#), Vendimi, i 26 shkurtit 2002 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 121),
66. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, Gjykata e Apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; shih, në kundërshtim me këtë, *Tatishvili kundër Ruisë*, nr. [1509/02](#), Aktgjykim, i 9 korrikut 2007, paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt merrej me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së, *Helle kundër Finlandës*, nr. [157/1996/776/977](#)), Aktgjykim, i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 122). Kjo kërkesë është aq më e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.

67. Megjithatë, Gjykatat e Apelit (në shkallën e dytë) të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih rastin e GJEDNJ-së, *Hansen kundër Norvegjisë*, nr. 15319/09, Aktgjykim, i 2 janarit 2015, paragrafët 77–83 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 123).

(ii) Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

68. Gjykata rikujton pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës që ndërlidhen me mungesën e arsytimit të gjykatave të rregullta, si në vijim (i) gjykatat e rregullta nuk i kishin trajtuar pretendimet e parashtruesit se i njëjti ishte larguar nga puna pa arsyetim; (ii) gjykatat e rregullta nuk ishin përgjigjur në pretendimin e tij se paragrafi 2 i nenit 100 të Kodit Penal të Kosovës, i cili ishte në fuqi në kohën kur parashtruesi ishte larguar nga puna, “*nuk ka mundur të përdoret si bazë për largim nga puna për faktin se kjo dispozitë përcaktonte shprehimisht se dënimi me kusht nuk krijon pasoja juridike dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës nuk është dashur të realizohet mbi këtë bazë*”; si dhe (iii) konkret nuk e kishin marrë parasysh Aktgjykimin [PML.nr.128/2016], të Gjykatës Supreme, i cili i kishte anuluar Aktgjykimet e instancave më të ulëta me të cilat parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor.
69. Në këtë drejtim Gjykata do të kujtojë përmbajtjen e vendimeve të gjykatave të rregullta, për të vlerësuar nëse të njëjtat përmbajnë arsyetim të mjaftueshëm në pretendimet specifike të parashtruesit.
70. Gjykata së pari rikujton se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.2060/2019], refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit duke vërtetuar Vendimin [nr. A/02/154/2016] e KPMSHCK-së, duke arsyetuar se vendimi për shkarkimin nga pozita e Zëvendës Drejtorit Menaxhues, Divizioni i Likuidimit të AKP-së, është bërë konform nenit 16 të Ligjit për AKP-në, sepse duke marrë parasysh përmbajtjen e kësaj të fundit pikërisht Bordi i Drejtorëve të AKP-së është kompetent për emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në AKP.
71. Më tej, Gjykata i referohet pjesëve të caktuara të Aktgjykimit [AA.nr.600/20], të 19 majit 2022, të Gjykatës së Apelit e cila refuzoi si të pathemeltë ankesën ku ndër të tjera theksoi se veprimet e AKP-së për largimin nga puna të parashtruesit “*janë veprime tërësisht të ligjshme në pajtim me nenin 58 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, e cila i referohet rasteve të rënda të sjelljes së keqe të punojtit*.” Më tej në Aktgjykim shtohet se në rastin konkret Bordi i Drejtorëve konstatoi se veprimet e parashtruesit konsiderohen si veprime që përbëjnë shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe, rrjedhimisht, Gjykata e Apelit konsideron se masa e shqiptuar nga AKP është proporcionale.
72. Sa i përket pretendimit të parashtruesit se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh Aktgjykimin [ARJ.nr.125/2022], të 27 dhjetorit 2022, të Gjykatës Supreme, përmes së cilit ishin anuluar vendimet me të cilat parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor, Gjykata e Apelit thekson se në rastin konkret “*nuk është arritur të vërtetohet ose jo përgjegjësia penale e paditësit për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale*”.

73. Gjithashtu Gjykata Supreme në vendimin e kontestuar pasi që kishte konstatuar se vendimet e instancave më të ulëta ishin të drejta dhe të ligjshme, theksoi se gjendja faktike ishte vërtetuar në mënyrë të drejtë. Gjykata Supreme në vendimin e saj lidhur me pretendimet specifike të parashtruesit shtoi si në vijim:
- (i) Lidhur me pretendimin e parashtruesit se vendimet administrative dhe të instancave më të ulëta gjyqësore nuk janë të arsyetuara, Gjykata Supreme theksoi se të njëjtat *“i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore por i refuzoi si jo të qëndrueshme dhe me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta, sepse fillimisht me aktgjykimet penale të shkallës së parë dhe të dytë të cekura si në aktgjykimet e instancave më të ulëta dhe si më lartë paditësi është shpallur fajtor dhe është dënuar për veprën penale shmangie mashtruese nga detyrimet nga neni 92, të Rreg 2004/1 të Unmik dhe është gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej dy vite me kush, përderisa me aktgjykimin e lartceku të Gjykatës Supreme PML.128/16 është miratuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë”* dhe janë anuluar vendimet e shkallëve më të ulëta. Sipas Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës nuk është liruar nga akuza apo nuk është shpallur i pafajshëm, por është arritur parashkrimi absolut, duke theksuar se *“ligjërish nuk përjashtohet përgjegjësia disiplinore edhe shqiptimi i masës disiplinore si në rastin konkret”*.
 - (ii) Lidhur me pretendimin e parashtruesit se kusht për t’u ndërprerë marrëdhënia e punës është dënimi me burgim efektiv prej 6 muajsh, Gjykata Supreme theksoi se *“i refuzon si jo të qëndrueshme sepse sipas këtij neni rregullohet përfundimi i marrëdhëdhies së punës sipas kushteve të cituara ligjore pavarësisht nga dëshira e nënpunësit civil ose institucioni, gjersa sipas nenit 87.1 të këtij ligji rregullohet shkarkimi i nënpunësit civil, si u theksua më lart nga shërbimi civil ndër shkaqet tjera të cituara më lart edhe për shkak të shkeljes së ligjit i cili ka rezultuar me vepër penale, si në rastin konkret”*
74. Nga arsyet e paraqitura më lart, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme si dhe dy gjykata të instancave më të ulëta, kanë dhënë arsye bindëse dhe të mjaftueshme për refuzimin e ankesës së parashtruesit duke pasur parasysh konstatimin e tyre të përbashkët se në rastin konkret vendimi i Bordit të Drejtorëve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është i drejtë dhe i ligjshëm, ndër të tjera, duke konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk është liruar nga akuza penale, por ndjekja e tij është bërë e pamundur për shkak të arritjes së parashkrimit absolut.
75. Gjykata, nga të gjitha shtjellimet e sipër theksuara, në rrethanat e rastit konkret, konsideron se parashtruesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë Gjykatës Supreme dhe instancave tjera. Megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së [Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë](#), Aktgjykim, i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
76. Përveç kësaj, Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar dhe vendimet e instancave më të ulëta, përmbajnë arsyetime logjike dhe sqarojnë me saktësi të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës (shih, rastet e GJEDNJ-së [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 30; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 28).
77. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës përkitazi me rastin konkret ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që

në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqet pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare në mënyrë efektive; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës; dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kontestuar janë paraqitur në detaje dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 21 janarit 1999, [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42; si dhe rasti [KI128/18](#), i cituar më lart, paragrafi 58).

78. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor, janë (i) pretendime që i takojnë kategorisë së “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

II. Përkitazi me pretendimet për shkelje të neneve 49 dhe 54 të Kushtetutës

79. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimeve për shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar, pretendon edhe shkelje të neneve 49 dhe 54 të Kushtetutës. Megjithatë, në këtë kontekst i njëjti vetëm i përmend këto nene, por nuk elaborohen dhe shtjellon më tej si dhe pse ka ardhur deri tek shkelja e tyre nga ana e Gjykatës Supreme. Siç është shprehur edhe në rastet e tjera, Gjykata përsërit qëndrimin e saj se vetëm përmendja dhe citimi i neneve të Kushtetutës apo instrumenteve të tjera ndërkombëtare, nuk mjafton për të ngritur pretendime për shkelje të të drejtave kushtetuese. Kur pretendon për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, parashtruesi duhet të paraqesë dëshmi dhe argumente bindëse për të dëshmuar shkeljet e supozuara (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues, *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; [KI166/20](#) parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 52; [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39, dhe [KI64/22](#), parashtrues *Vatani Shpk*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 shtatorit 2022, paragrafi 77).
80. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e neneve të lartcekura, në baza kushtetuese duhet deklaruar qartazi të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) dhe 116 (2) të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 34 (2), si dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 30 prill 2024, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. TË KONSTATOJË se ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani